

**LIGJI NR. 08/L-102****PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 04/L-139 PËR PROCEDURËN PËRMBARIMORE I NDRYSHUAR DHE PLOTËSUAR ME LIGJIN NR. 05/L-118****Kuvendi i Republikës së Kosovës:**

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

**LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 04/L-139 PËR PROCEDURËN PËRMBARIMORE I NDRYSHUAR DHE PLOTËSUAR ME LIGJIN NR. 05/L-118****Neni 1  
Qëllimi**

Qëllimi i këtij ligji është ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.05/L-118 (në tekstin e mëtejme: Ligji bazik).

**Neni 2**

Neni 2 i Ligjit bazik, paragrafi 1, pas nënparagrafit 1.20 shtohet nën paragraf i ri, si në vijim:

1.21. Institucionet publike - në kuptim të këtij ligji nënkupton Zyrën e Kryeministrit, ministrinë dhe agjencitë ekzekutive në kuadër të tyre, agjencitë e pavarura, agjencitë rregullatorë, inspektoratet, ndërmarrjet publike në nivel qendror dhe lokal, komunat, si dhe autoritetet që ushtrojnë kompetenca gjyqësore dhe prokuroriale apo institucione të tjera publike të përcaktuara me ligj.

**Neni 3**

1. Neni 5 i ligjit bazik, paragrafi 6, nën-paragrafi 6.2, fjalët “dhe kompensimet tjera.”, fshihen.

2. Neni 5 i ligjit bazik, pas paragrafit 6 shtohet paragraf i ri 7, si vijon:

7. Përmbaruesi privat është kompetent për të vendosur në procedurën e përmbarimit dhe zbatimin e përmbarimit të vendimeve gjyqësore, lidhur me kompensimet nga marrëdhënia e punës.

**Neni 4**

Nenit 111 i Ligjit bazik, pas paragrafit 2 i shtohet paragraf i ri, si në vijim:

3. Objekt përmbarimi nuk mund të bëhen të hyrat nga pakot emergjente apo masat specifike të miratuara nga Qeveria për rrethana të jashtëzakonshme apo emergjente, siç janë pandemitë apo fatkeqësitë natyrore.

**Neni 5**

1. Neni 112 i ligjit bazik, paragrafi 1, riformulohet si vijon:

1. Përmbarimi në të ardhurat personale dhe për shpërblimin në vend të pagës, mund të

caktohet dhe zbatohet deri në gjysmën e lartësisë së tyre. Shuma që sekuestrohet do të kufizohet në pjesën që tejkalon shumën e ndihmës më të lartë sociale.

2. Neni 112 i Ligjit bazik, pas paragrafit 1 shtohet paragraf i ri, si në vijim:

1a. Përmbarimi në të ardhurat për pensionin mund të caktohet dhe zbatohet deri në pjesën që e tejkalon shumën e lartësisë së pagës minimale.

3. Neni 112 i ligjit bazik, paragrafi 3 pas fjalës “së përkohshme” fshihen fjalët “për të ardhurat në bazë të shtesave për fëmijë”.

## **Neni 6**

Neni 18 i ligjit bazik, paragrafi 2, nën-paragrafi 3a, fshihet.

## **Neni 7**

Neni 22 i ligjit bazik, pas paragrafit 3, shtohet nën-paragraf i ri 3a, me tekstin si në vijim:

3a. Në rastet kur vlera e paluajtshmërisë është më e madhe sesa kërkesa kreditore, përfshirë edhe shpenzimet procedurale, atëherë kreditori detyrohet që debitorit, në afat prej tridhjetë (30) ditëve, t'ia kthejë diferencën mes shumës së obligimit dhe një e treta (1/3) e vlerës së paluajtshmërisë.

## **Neni 8**

Neni 247 i ligjit bazik, paragrafi 2, fshihet.

## **Neni 9**

1. Neni 323 i ligjit bazik, pas paragrafit 4 shtohen paragrafët e ri 4a dhe 4b me tekstin si në vijim:

4a.1. Lëndët përmbarimore për të cilat institucioni publik është kreditor dërgohen në Odë.

4a.2. Lënda përmbarimore nga nën-paragrafi 4a.1. përfshin propozim për përmbarim dhe dokumentin përmbarues apo dokumentin e besueshëm.

4a.3. Oda do ta bëjë ndarjen e barabartë të lëndëve të pranuar nga institucionet publike tek përmbaruesit privat:

4a.3.1. sipas radhës së pranimit;

4a.3.2. sipas renditjes alfabetike të regjistrimit të përmbaruesve në regjistrin e përmbaruesve brenda territorit të Gjykatës Themelore për të cilën përmbaruesi privat është emëruar dhe në të cilën debitori e ka selinë ose vendbanimin.

4a.4. Oda e njofton përmbaruesin privat të cilit i është ndarë lënda përmbarimore sipas paragrafit 4a.2. dhe e fton për marrjen e saj në afat prej tre (3) ditësh nga dita e pranimit të lëndës.

4a.5. Përmbaruesi privat pas pranimit të lëndës përmbarimore nga Oda e njofton menjëherë kreditorin dhe komunikimi lidhur me procedurën përmbarimore për rastin zhvillohet mes organit përmbarues dhe palëve.

4a.6. Lëndët përmbarimore të pranuar në Odë, evidentohen sipas radhës së pranimit në regjistrin përkatës të Odës dhe në çdo lëndë vendoset vula elektronike me rastin e pranimit. Një dëshmi e pranimit të lëndës përmbarimore i dorëzohet institucionit publik

me rastin e dorëzimit.

4a.7. Oda në baza vjetore i dërgon raport me shkrim Ministrisë së Drejtësisë për zbatimin e këtij neni.

4.b. Institucionet publike me rastin e dërgimit të lëndëve përmbareme në Odë i paguajnë një taksë për shërbimet lidhur me ndarjen e lëndëve Odës, e cila përcaktohet me aktin përkatës nënligjor për tarifat dhe kompensimin e shpenzimeve për përmbareuesit privat.

### **Neni 10**

Pas nenit 341, shtohet nen i ri, si në vijim:

#### **341 A**

1. Përmbareuesi privat veprimet në caktimin dhe zbatimin e përmbareimit, menaxhimin e lëndës, kërkimin dhe shkëmbimin e të dhënave në regjistrat publikë dhe regjistrat tjerë në të cilat sipas dispozitave ligjore i ofrohet qasja, si dhe raportimin mbi punën e tij duhet ta bëjë përmes sistemit elektronik qendror të miratuar nga Ministria e Drejtësisë.

2. Në zbatim të paragrafit 1 të këtij neni, Ministria e Drejtësisë nxjerrë Udhëzues.

3. Përmbareuesi privat si bartës i autorizimeve publike ka të drejtë të ketë qasje elektronike në të gjitha regjistrat publik që kanë të dhëna të nevojshme dhe të përshtatshme për të zbatuar përmbareimin pa pagesë përveç nëse parashihet ndryshe me legjislacion.

4. Përrjashtimisht, përmbareuesi mund të zbatojë përmbareimin në mënyra tjera vetëm nëse ekzistojnë rrethanat që e bëjnë të pamundur qasjen dhe përdorimin e sistemit elektronik qendror të përmbareimit, ndërsa përmbareuesi nuk ka pasur asnjë ndikim në shkaktimin e këtyre rrethanave.

5. Pas pushimit të rrethanave sipas paragrafit 4 të këtij neni, përmbareuesi do të plotësojë këto të dhëna në sistemin elektronik qendror të përmbareimit.

### **Neni 11**

Neni 368 i ligjit bazik, paragrafi 3, togfjalëshi “në buxhetin e Republikës së Kosovës”, ndryshohet me togfjalëshin “në buxhetin e Odës së Përmbareuesve”.

### **Neni 12**

Neni 370 i ligjit bazik, paragrafi 3, ndryshohet si vijon:

3. Anëtarët e Komisionit disiplinor kanë të drejtë në shpërblim për punën nga mjetet e Buxhetit të Republikës së Kosovës, në lartësi të cilën e cakton ministri i Drejtësisë.

### **Neni 13**

Neni 376 i Ligjit bazik, pas paragrafit 2, shtohet një paragraf i ri 2a. si vijon:

2a. Në rastet e pushimit për çfarëdo arsye të funksionit të përmbareuesit privat, sipas paragrafit 1 të nenit 376 të ligjit bazik, lëndët përmbareme dhe të dhënat tjera që ndërlidhen me veprime përmbareme, barten në mënyrë proporcionale të përmbareuesit e territorit të Gjykatës Themelore, për të cilën përmbareuesi që i ka pushuar funksioni ka qenë i emëruar, proces i cili menaxhohet nga Komisioni i përbashkët i Ministrisë së Drejtësisë dhe Odës së Përmbareuesve Privatë, me pjesëmarrje të përmbareuesve që i

delegohen lëndët.

#### **Neni 14**

1. Ministri i Drejtësisë nxjerr akt nënligjor, me të cilin përcaktohen standardet profesionale të përmbaruesve privatë.
2. Brenda periudhës jo më larg se gjashtë (6) muaj, pas hyrjes në fuqi të këtyre ndryshimeve, Ministria e Drejtësisë dhe Oda e Përmbaruesve të Kosovës, nxjerrin udhëzimet dhe rregulloret përkatëse për zbatimin e rregullimeve, si më lart.

#### **Neni 15** **Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr. 08/L-102**  
**13 korrik 2023**

**Shpallur me dekretin Nr. DL-142/2023, datë 01.08.2023 nga Presidentja e Republikës së Kosovës Vjosa Osmani-Sadriu**